# DËSHMI ARKIVI

**A-444610**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Polici që goditi qytetarin me grusht emërohet Gjeneral i Trupave Speciale të Serbisë |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1391663.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 21:14:04 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 14 shtator 2026, 21:05:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 14 shtator 2026, 21:04:00 UTC → 14 shtator 2026, 21:06:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `988ca0b0b7a7c4e94423e4c003baf9c003a720625d7627363dd7138ed6c02d92` |
| TEKSTI | `a541c559770a0c94c97cf437abee6c143ccb904f8522212275f8374ff4397732` |
| PAMJA | `df043b33c4a07a1e74233c1d7e0f89d30cc2ccd12f3c0ddf656c8d5eaf4dd182` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `49c24677865aa374f16b6d086507a17812086431b8257c732b205f84e7f99933` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `14f4bd53e2e66d8385ba6de2378a49e0445f54add9285267e471b01ae86271f6` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/49c24677865aa374f16b6d086507a17812086431b8257c732b205f84e7f99933`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Polici që goditi qytetarin me grusht emërohet Gjeneral i Trupave Speciale të Serbisë

Shkruar nga: M Gjini | Publikuar më: 14.09.2026, 23:05

Share Share




*Nga Ministria e së Vëretës.*

Në një ceremoni të improvizuar drejtpërdrejt në trotuar, Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, ka dekoruar me dekoratën më të lartë ushtarake policin që u filmua sot duke stërvitur grushtin e tij direkt në stomakun e një qytetari të paarmatosur.

Sipas burimeve konfidenciale nga Beogradi, Vuçiç e kishte ndjekur skenën nga afër me buzëqeshje prindërore dhe duartrokitje entuziaste, duke e cilësuar goditjen si *"forma më e pastër e diplomacisë dhe menaxhimit të turmës që nga shekulli i kaluar"*.

"Kemi vite që shpenzojmë miliona euro për të stërvitur ushtrinë tonë, por ky djalosh tregoi me një të rënë të vetme të krahut se çfarë do të thotë disiplinë e vërtetë," deklaroi një Vuçiç i emocionar, ndërsa fshinte një lot gëzimi nga syzet. "Efektshmëria e tij, teknika e grushtit anësor pa asnjë hezitim apo konsideratë për të drejtat e njeriut, është saktësisht ajo që i mungonte forcave tona të armatosura."

Polici i sapopromovuar do të marrë menjëherë gradën e Gjeneralit të Trupave Speciale dhe do të jetë përgjegjës për modulit e ri të stërvitjes me titull: *"Si të shmangësh bisedimet diplomatike duke përdorur vetëm grushtin e djathtë"*.

Përveç gradës së re ushtarake, Gjeneral 'Grushti' ka marrë edhe ftesë zyrtare për të mbajtur një leksion të hapur në Akademine e Policisë Serbe mbi temën *"Si të rrahësh popullin e pambrojtur"*.

Ndërkohë, viktima e goditjes raportohet se ka kërkuar falje zyrtare që i pengoi grushtin e policit me stomakun e tij, duke premtuar se herën tjetër do të stërvitet më shumë për të mbajtur goditjet që të mos i prishë gradën gjeneralit të ri.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME



Më të Lexuarat

ARTIKULL JOETIK?




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.